



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	23.09.2022
REFERENC-Ë:	02-052/01-0087290/22
PËR/ZA/TO:	Vesa Broja- Kryesuese e Kuvendit Komunal
KOPJE :	Bedri Hamza- Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Igballe Islami – Drejtore Adem Fazliu- ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga procesi i mbajtjes së konsultimit publik për planifikimin buxhetit të komunës së Mitrovicës për vitin 2023-2025



E nderuar,

Në vijim të këtij raporti gjeni një përmbledhje të kërkesave të qytetarëve, anëtarëve pjesëmarrës të Asambles Komunale si dhe disa të dhëna nga draft-Buxhetit të Komunës së Mitrovicës për vitin 2023, i cili në total arrin vlerën 25,011,350.00 €.

Pjesëmarrja e kategorive ekonomike në totalin e buxhetit është si në vijim:

- Paga dhe Mëditje, në shumë prej 12,603,554.00 euro;
- Mallra dhe Shërbime në shumë prej 3,838,141.00euro;
- Shpenzime Komunale, në shumë prej 610,100.00 euro;
- Subvencione dhe Transfere në shumë prej 1,227,659.00 euro;
- Investime Kapitale në shumë prej 6,731,896.00 euro.

Konsultimi publik për planifikimin e buxhetit të komunës për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025

Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, me praktikën e mira të buxhetimit si dhe me instruksionet e dhëna nga MFPT. Komuna e Mitrovicës përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka organizuar gjithsejtë tetë (8) dëgjime buxhetore, duke ftuar për pjesëmarrje të gjithë qytetarët pa dallim etnie e gjinie, nga qyteti e fshati për të dhënë propozimet/kërkesat e tyre. Në këtë vit kemi organizuar dëgjimet buxhetore në dy modalitete, duke përfshirë takimet në teren - në fshatra, lagje dhe lokalitete me qytetarë dhe takimet tjera të mbajtura në Sallën e Kuvendit Komunal në Mitrovicë. Dëgjimet buxhetore kanë filluar me datën 20.07.2022 dhe kanë përfunduar më datë 28.07.2022.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka trajtuar me kujdes të veçantë secilën kërkesë të qytetarëve duke i përmbledhur në një raport, të gjitha dëgjimet buxhetore me qytetarët dhe me datë 02.08.2022 i ka dorëzuar kryetarit të komunës dhe drejtorëve komunal që me rastin e planifikimit të draft-buxhetit 2023-2025 të kenë në konsideratë.

Mirëpo në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 i Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; neni 61 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; neni 6 pika 1.2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 Për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryesuesja e Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim kanë organizuar konsultim publik për projekt buxhetin e komunës së Mitrovicës për vitin 2023 dhe parashikimet për 2024 dhe 2025.

Thirrja e këtij konsultimi publik është bërë nga Sekretaria e Kuvendit të Komunës në harmoni me Udhëzimin për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike.

Konsultimi publik u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal me datë 22.09.2022 ku morën pjesë 46 pjesëmarrës. Të gjithë të pranishmit kanë pasur mundësitë të paraqesin kërkesat e tyre duke i paraqitur publikisht para të pranishmeve si dhe përmes kartelave me shkrim.

Kërkesat Sugjerime Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sygjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
<p>a). Kërkesë për ndriqim publik në rrugën Nora Kelmedi- Shipol</p> <p>b). Rregullimi i asfaltit ku janë vendosur gypat e ri të ujësjellësit në rrugën Nermin Vlora</p>	<p>Nexhat Hasani</p>	<p>a) I pranuar</p> <p>b) I pranuar pjesërisht</p>	<p>a). Është futur në buxhet në kuadër të projektit për zgjerimin e rrjetit të ndriqimit publik në kuadër të drejtorisë për shërbime publike dhe infrastrukturë</p> <p>b). Në kuadër të projekteve kapitale në DSHPI është planifikuar edhe projekti për asfaltimin dhe rregullimin e rrugëve, ndërkohë do të bëhet përpjekje për të intervenuar edhe në rrugën Nermin Vlora</p>
<p>a). Kërkesë për asfaltim të rrugës Vigu</p> <p>b). Ndriqim i rrugës kryesore</p> <p>c). Vendosja e gypave të kanalizimit për lagjen Imeri</p> <p>d). Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore</p>	<p>Lulzim Hasani –kryetar i fshatit Vinarc i Epërm</p>	<p>a) I pranuar</p> <p>b) I pranuar</p> <p>c) I pranuar</p> <p>d) I pranuar</p>	<p>a). Në projektet kapitale të drejtorisë për shërbime publike dhe infrastrukturë është planifikuar edhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Vinarc</p> <p>b) Është futur në buxhet në kuadër të projektit për zgjerimin e rrjetit të ndriqimit public</p> <p>c) Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe pusetat</p> <p>d). Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore do të bëhet në kuadër të projektit për rregullimin e trotuareve</p>
<p>a). Kërkesë për zgjerim të rrjetit të kanalizimit në fshatin Broboniq.</p>	<p>Aziz Ademi</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Në projektin për zgjerim të rrjetit të kanalizimit është edhe fshati Broboniq</p>

<p>a). Ndërtimi i urës mbi lumin Ibër</p> <p>b). Qendra rinore për të rinjtë</p> <p>c). Rregullimi i pjesës hixhenike në shkollën ekonomike Hasan Prishtina</p> <p>d). Masa kundër qenëve endacak</p>	<p>Deniz Hajrullahu</p>	<p>a). I pranuar pjesërisht</p> <p>b). I pranuar pjesërisht</p> <p>c). I pranuar</p> <p>d). I pranuar</p>	<p>a). Projekti për rregullimin e shtratit të lumit Ibër</p> <p>b). DKRS e ka subvencionuar qendrën rinore dhe janë në zyret e përkohshme ku janë edhe zyret e DKRS-së ku për momentin janë në kërkim të kthimit të këtij objekti në pronë komunale</p> <p>c). Rregullimi i shkollës së mesme Frang Bardhi dhe Hasan Prishtina është projekt i planifikuar për vitin 2023 ne kuadër të DKA-së. Ndërsa mirëmbajtja e objektit është obligim i stafit teknik të shkollës mirëpo gjithsesi që do të ndërrmarrim veprime në këtë drejtim</p> <p>d). Në kategorinë mallra dhe shërbime në drejtorinë për menaxhimin e fatkeqësive natyrore është planifikuar shuma prej 150,000 € për trajtimin e qenëve endacak</p>
<p>a). Asfaltimi i rrugës Vinarç-Koshtovë</p> <p>b). Kërkesë për zgjerim të rrjetit të kanalizimit, ndriqimit publik dhe trotuari</p> <p>c). Mungesa e ujit të pijshëm</p> <p>d). Të shtrohen rrugët/rrugicat nga lagjia Hajredinaj-Jashari</p>	<p>Haxhi Salihu- përfaqësues i fshatit Koshtovë</p>	<p>a). I pranuar</p> <p>b). I pranuar</p> <p>c). I pranuar pjesërisht</p> <p>d). I pa pranuar</p>	<p>a). Është planifikuar projekti për vitin 2024 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Gushavc dhe Vinarç, ndërsa për vitin 2023 në kuadër të projektit për asfaltim dhe rregullim të rrugëve është edhe fshati Vinarç</p> <p>b). Në kuadër të projekteve në DSHPI është planifikuar që të bëhet zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Koshtovë si dhe në projektin për ndërtimin e trotuareve është planifikuar ndërtimi i trotuarit në fshatin Koshtovë</p> <p>c). Do të bëjmë përpjekje që në koordinim me KRU ‘Mitrovica’ të zgjedhim problemin e ujit të pijshëm</p> <p>d). Gjatë planifikimit të buxhetit 2024-2026 do të trajtohet me kujdes të veçantë kjo kërkesë meqenëse mundësitë buxhetore kanë qenë të kufizuara</p>

<p>a). Përfundimi i projektit të shkollës Harun Beka</p> <p>b). Vazhdimi i rrugës nga xhamija deri tek Liqeni Akumulues si dhe asfłatimi i rrugës së “Shehrit”</p> <p>c) Rregullimi i rezervuarëve të ujit në lagjen Hajdari</p> <p>d).Subvecnioni i bujqëve (mosdiskriminim)</p>	<p>Fatmir Zeka Nazmi Beka-Gushavc</p>	<p>a). I pranuar</p> <p>b). I pranuar</p> <p>d) I pranuar</p>	<p>a).Instalimi dhe montimi i kalldasë në shkollën Harun Beka është projekt në buxhetin 2022 dhe është në procedurë të prokurimit</p> <p>b). Ndërtimi i rrugëve në fshatin Gushavc dhe Vinarc është projekt i planifikuar për vitin 2024</p> <p>d) Kemi planifikuar rritje të subvencioneve në drejtorinë e bujqësisë, ndërsa shpërndarja e tyre bëhet bazuar në Rregulloren komunale për shpërndarje të subvencioneve</p>
<p>a). Ndërtimi i rrugës Ali Zeneli dhe rrugëve Lah Nimani dhe Evlia Çelebia janë projekte të vitit 2022 të cilat janë në procedurë të prokurimit dhe për të cilat është bërë ndarje buxhetore edhe për vitet 2023-2024</p>	<p>Ramadan Smakolli</p>	<p>a) I pranuar</p>	<p>a). Ndërtimi i rrugës Ali Zeneli dhe rrugëve Lah Nimani dhe Evlia Çelebia janë projekte të vitit 2022 të cilat janë në procedurë të prokurimit dhe për të cilat është bërë ndarje buxhetore edhe për vitet 2023-2024</p>
<p>a). Rritja e buxhetit për ZKKK</p> <p>b) Zgjerim i rrjetit të kanalizimit dhe zgjerim i rrjetit të ndriqimit publik në lagjen 2 Korrik</p> <p>c)Bursa për nxënës të komunitet romë</p>	<p>Jeton Rrahmani</p>	<p>a). I pranuar</p> <p>b). I pranuar pjesërisht</p> <p>c). I pranuar</p>	<p>a) Është rritur buxheti në kategorinë ekonomike subvencione tek ZKKK</p> <p>b). Në kuadër të projekteve për zgjerim të rrjetit të ndriqimit publik, zgjerimit të kanalizimit do të intervenohet edhe në lagjen 2 Korriku.</p> <p>c). Është planifikuar rritje e buxhtit për ndarjen e bursave për student, andaj edhe do të ketë mundësi më të mëdha për të qenë përfitues</p>

<p>a). Kërkesë për rregullimin e sallës së edukatës fizike në shkollën e mesme ekonomike “Hasan Prishtina”</p>	<p>Gresa Voca</p>	<p>a). I pranuar</p>	<p>a) Në kuadër të drejtorisë së arsimit është planifikuar edhe Rregullimi i shkollës së mesme “Frang Bardhi “ si dhe shkollës së mesme “Hasan Prishtina’</p>
<p>a). Asflatimi i rrugës Lulzim dhe Bedri Balii në fshatin Koprivë</p> <p>b). Rryma në fshat</p>	<p>Xhelazim Balii-kryetar i fshatit Koprivë</p>	<p>a). I pranuar pjesërisht</p> <p>b). I papranuar</p>	<p>a) Planifikohet rregullimi i rrugës me zhavor në këtë vit</p> <p>b). Komuna nuk ka të drejtë të planifikojë projekte kapitale që janë në përgjegjësi të KEK/KESSCO</p>
<p>a). Pagesa e shujtave sipas vendimit të marrë nga KK në seancën e dt. 28.01.2021 për kërkesën e bërë nga sindikata e të punësuarëve të komunës së Mitrovicës</p> <p>b). Të ndahet një sasi e të hollave për trajtimin e qenëve endacakë.</p>	<p>Elidiana Budini-Haziri</p>	<p>a). I pranuar</p> <p>b). I pranuar</p>	<p>a) Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me datë 22.09.2022 është vendosur që shujtat të jenë pjesë e buxhetit për vitin 2023</p> <p>b). Në kuadër të drejtorisë për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore tek kategoria Mallra dhe Shërbime është planifikuar shuma prej 150,000 € për trajtimin e qenëve endacakë</p>

<p>a). Rritja e buxhetit të ZKKK</p> <p>b). Punësimi në ZKKK</p>	<p>Bashkim Krasniqi</p>	<p>a). I pranuar</p> <p>b). I pranuar</p>	<p>a). Është rritur buxheti në kategorinë ekonomike subvencione tek ZKKK</p> <p>b). Është rritur numri i stafit për një pozitë në ZKKK për vitin 2023</p>
<p>a). Hapësira e qendrës rinore</p> <p>b). Rritja e buxhetit për subvencionim të aktiviteteve për të rinjtë</p>	<p>Diellza Zejnullahu</p>	<p>a). I pranuar pjesërisht</p> <p>b). I pranuar</p>	<p>a). DKRS e ka subvencionuar qendrën rinore dhe janë në zyrat e përkohshme ku janë edhe zyrat e DKRS-së ku për momentin janë në kërkim të kthimit të këtij objekti në pronë komunale</p> <p>b). DKRS ka rritje të buxhetit në kategorinë ekonomike subvencionet, ndërsa përveq thirrjes së parë është planifikuar thirrje e veçantë për vitin 2022 dhe 2023 për aktivitet rinore</p>

<p>a). Rregullimi i rrugës “Evlia Çelebia”</p> <p>b). Mbeturinat janë në një të pozicion të gabuar</p> <p>c). Qendra rinore</p> <p>d). Trajtimi i qenëve endacakë</p>	<p>Emir Salihu</p>	<p>a). I pranuar</p> <p>b). I pranuar pjesërisht</p> <p>c). I pranuar pjesërisht</p> <p>d). I pranuar</p>	<p>a). Rregullimi i rrugës “Evlia Çelebia” është projekt në buxhetin e vitit 2022 dhe do të vazhdoj edhe në vitet 2023-2024</p> <p>b). Kompania regjionale “Uniteti” është përgjegjëse për mbledhjen dhe pozicionimin e kontinjërëve mirëpo në bashkëpunim të ngushtë me ndërrmarjen do të zgjidhet problemi me trajtimin e mbeturinave</p> <p>c). DKRS e ka subvencionuar qendrën rinore dhe janë në zyrat e përkohshme ku janë edhe zyrat e DKRS-së ku për momentin janë në kërkim të kthimit të këtij objekti në pronë komunale</p> <p>d). Në kuadër të drejtorisë për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore tek kategoria mallra dhe shërbime është planifikuar shuma prej 150,000 € për trajtimin e qenëve endacakë.</p>
---	--------------------	---	---

Me respekt,